



**KOMUNA E KLINËS
KUVENDI I KOMUNËS**

01.NR. 06 - 6.111/17

KLINË, 21.12.2017

PROCESVERBAL

**I SEANCËS INAUGURUESE TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË KLINËS, MBAJTUR,
MË 21.12.2017, NË ORËN 10:00, NË SALLËN E KUVENDIT TË KOMUNËS**

RENDI I DITËS

1. Fjala mirëseardhëse e Anëtarit më të vjetër të Kuvendit të Komunës (Kryesues i mbledhjes),
2. Dhënia e betimit e anëtarëve të Kuvendit të Komunës,
3. Dhënia e betimit të Kryetarit të Komunës, Prof. Dr. Zenun Elezaj,
4. Fjala përshdnetëse e Kryetarit të Komunës,
5. Zgjedhja e Kryesuesit të Ri të Kuvendit të Komunës.

Në seancë prezantuan: Kryetari (i Ri), i Komunës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, nënkryetari (aktual) i Komunës, Enver Berisha, anëtarët e Kuvendit (26), drejtorë të drejtorive, Zyra ligjore, komandanti i Policisë në Klinë, Rexhë Berisha, kleri shqiptar, përfaq. të OSBE-së, përfaq. të KFOR-it, përfaq. të OSBE-së, përfaq. të OVL-ve, të invalidëve të luftës, të familjeve të dëshmorëve, të familjeve të të pagjeturve, OJQt-ë, Zyrtarja për Barazi Gjinore, mediet, qytetarë etj.

Seancën e hapi anëtari më i vjetër i Asamblesë Komunale, z. Zeqir Morina, i cili fillimisht i përshëndeti të pransihmit dhe ju uroi mirëseardhje në këtë seancë të KK të inaugurimit të Kryetarit të Komunës dhe të Kryesuesit të Kuvendit.

Kryesuesi i seancës, z. Morina, në vijim kërkoi nga anëtarët që të zgjedhin Komisionin për Verifikimin e mandatit të anëtarëve të Kuvendit. Kryesuesi Morina propozoi që ky komision të formohet nga 3 anëtarë ose 5 anëtarë.

Kryesuesi vuri në miratim propozimin që komisioni t'i ketë 3 anëtarë.

Me vota unanime u miratua propozimi që komisioni t'i ketë 3 anëtarë.

U procedua me propozimet e anëtarëve të Komisionit për Verifikimin e Mandatit.

Esat Raci, propozoi Asdren Ramadanin
Skënder Merturi, propozoi Petrit Palushin
Violeta Zefi, propozoi Enver Gashin

Me vota unanime u zgjodh komisioni me këtë përbërje:

1. Asdren Ramadani (PDK)
2. Petrit Palushi (AAK)
3. Enver Gashi (LDK)

Në vijim u procedua në dhënien e betimit të anëtarëve të KK-së. Kryesuesi Morina sqaroi procedurat e dhënies së betimit nga ana e anëtarëve.

Anëtarët e KK-së dhanë Deklaratën e betimit solemn.

Enver Berisha, kryetar i GP të PDK-së: “ Në emrin tim dhe të GP të PDK-së –dega në Klinë, uroj dhënien e betimit të asamblistëve të rinj, me shpresë se në rend të parë të kanë shëndet dhe të jenë në vazhden e përgjegjësive që kanë marrë nga elektorati, që të jenë në shërbim dhe në funksion të qytetarëve të Komunës sonë. I vetëdijshëm se kjo seancë e sotme është solemne dhe, vërtet, edhe prezenca juaj po jep këtë karakter solemn, po i bindur se do të ishte edhe më madhështore po të ishte këtu edhe Kryetari aktual, z. Sokol Bashota. Dhe, mungesa e tij flet dhe duke e pasur parasysh a është mungesë e kulturës, a është mungesë e një qëllimi të caktuar, apo është edhe mospërvojë në këtë drejtim. Por, sigurisht, që prezenca e zotit Bashota do ta madhështonte këtë solemnitet të këtij betimi që ne po e bëjmë sot dhe Kryetari i ri.

Duke e pasur parasysh që dhjetë vitet e udhëheqjes së tij, ai ka lënë gjurmë të veta në Klinë. Ka lënë gjurmë të veta me shumë projekte kapitale, që, vërtet, qytetarëve të Klinës u është mundësuar të kenë një jetë më të mirë dhe njëherësh të ndjehen krenarë në komunën e vet. Janë shumë punë që janë kryer, janë shumë projekte që janë realizuar dhe janë shumë projekte që janë në realizim e sipër falë pikërisht atij angazhimi të zotit Bashota dhe PDK-së –dega në Klinë.

Ne si subjekt politik në Klinë kemi dalë partia e parë, dhe kemi dalë bindshëm partia e parë. Po ashtu edhe zoti Bashota është votuar maksimalisht nga elektorati i Klinës. Por sido që të jetë ka qenë detyrë e Kryetarit në ardhje, në bazë të një rekomandimi që është nga MPL, që të koordinohet bartja e përgjegjësive në mandatin e ri dhe në ekzekutivin e ri. Kjo nuk ka ndodhë. Dhe, zoti Bashota nuk është ftuar në këtë eancë si kryetar ose si ish- kryetar i Komunës, por i është dërguar një ftesë si një qytetari të thjeshtë, që vërtet është një mosrespekt, për angazhimin, për punën dhe kontributin që ka dhënë. Dhe si

rezultat i kësaj, duke i dëshiruar qeverisë në ardhje suksese dhe punë dhe të vetëdijshëm se ne si opozitë dhe si partia më e madhe në Klinë do të jemi kujdestare e interesave të qytetarëve të Klinës, ne nuk do të jemi në momentin solemn të dhënies së betimit të Kryetarit. Kështu që, do të kthehem në pjesën e dytë. Urime dhe suksese ju asmblistëve të kësaj asambleje të Komunës sonë”, ka konstatuar anëtari Enver Berisha.

Në vijim Grupi parlamentar i PDK-së lëshoi seancën, përkatësisht pjesën e dhënies së betimit të Kryetarit të Komunës, Prof. Dr. Zenun Elezajn.

Zeqir Morina, ftoi kryetarin e Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezajn që ta bëjë betimin solemn.

Kryetari i Komunës, Prof. Dr. Zenun Elezaj dha betimin solemn.

Zenun Elezaj: “Deklaratë solemne e betimit,

Unë, Zenun Elezaj, betohem - deklaroj solemnisht që do t’i kryej detyrat dhe do t’i ushtroj kompetencat si kryetar i Komunës së Klinës me nder, besnikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me Ligjin në mënyrë që t’i siguroj kushtet për një jetë të qetë për të gjithë. Faleminderit”!- u deklarua në betimin e tij Kryetari Elazaj.

Zeqir Morina, tha se tani sipas agjendës Kryetari i ri e ka fjalën. Kryesuesi Morina fjalën e barti te Kryetari i posazgjedhur i Komunës.

Zenun Elezaj: “Të nderuara familje të dëshmorëve, invalidë dhe veteranë të UÇK-së, të nderuar asamblistë të Komunës së Klinës, përfaqësues të Policisë së Republikës së Kosovës, përfaq. të KFOR-it, OSBE-së, zonja dhe zotërinj, miq të ftuar dhe gjithë ju t’ë pranishëm,

Kam kënaqësinë që të jem sot këtu prara jush në këtë Kuvend dhe këtë moment solemn, ku po bëhet edhe inaugurimi i asamblistëve të Kuvendit, Kryetarit dhe zgjedhja e Kryesuesit të KK të Klinës. Është moment i krenarisë sime, po edhe i përgjegjësive, sepse sot po marrim barrën e përgjegjësive dhe detyrave të reja që na presin përgjatë 4 viteve të ardhshme. Pa hezitim shpreh konsideratën time më të lartë për të gjithë ata që ranë, u sakrifikuan dhe u flijuan nëpër të gjitha etapat e historisë sonë kombëtare për lirinë dhe pavarësinë e Republikës së Kosovës, ku sot ndërtojmë institucione dhe krijojmë organe udhëheqëse në shërbim të të gjithë qytetarëve. Falënderim për ish-kryetarin e Komunës së Klinës, zotin Sokol Bashota dhe të gjithë asamblistëve të Kuvendit Komunal të Komunës tonë.

Parim i qeversjes sime do të jetë qeverisja me qytetarët dhe për qytetarët në mënyrën më transparente dhe llogaridhënëse. Prandaj, ndjej obligim moral dhe institucional që t’i falënderoj të gjithë ata qytetarë që kontrbuan dhe u angazhuan që unë të jem I Pari i Komunës së Klinës për 4 vjet.

Zotohem sot këtu prara jush se si Kryetar i Komunës së Klinës do të jem i paanshëm, unifikues; do të punojmë së bashku që të kthejmë dhe fuqizojmë rolin në këtë Kuvend. Do të punojmë me të gjitha grupimet politike pa dallime. Unë dhe asamblistët e KK të Klinës e kemi vetëm një detyrë: që t'ju shërbjmë qytetarëve me respekt dhe dinjitet. Do të ketë zero tolerancë kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe dukurive tjera negative; trajtim meritor për kategoritë e dala nga Lufta e UÇK-së dhe rastet tjera sociale.

Të nderuar asamblistë dhe ju gjithë bashkëpunëtorë të mi,

Kërkoj nga ju që të jemi bashkudhëtarë të të gjitha proceseve të zhvillimit që Komunës dhe gjithë qytetarëve të Komunës së Klinës t'ju sjellim begati dhe gjithë të mira në jetë. Do të ndjehesha shumë i lumtur në qoftë se gjatë rrugëtimit tim do të kisha përkrahjen tuaj.

Une personalisht do të jem i përkushtuar për t'i çuar dhe kapitalizuar të gjitha projektet, të cilat i kam prezantuar para qytetarëve gjatë fushatës zgjedhore.

Besoj dhe shpresoj se qeverisja, gjegjësisht organet qeverisëse të Komunës sonë do të jenë model për qeverisje për komunitat tjera të Republikës së Kosovës. Faleminderit shumë!”- ka konstatuar Kryetari Elezaj.

Pas pauzës një orëshe u procedua me pjesën e dytë të seancës, zgjedhjen e Kryesuesit të KK.

Zeqir Morina, kërkoi që të procedohet me pjesën e dytë të seancës së KK, zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit.

Në vijim kryesuesi i seancës, Zeqir Morina, lexoi procedurat e zgjedhjes së Kryesuesit të Kuvendit të Komunës. Kryesuesi Morina, po ashtu sqaroi se duhet të formohet Komisioni për Mbarëvajtjen e Procesit të Votimit.

U procedua me propozimin e Kryesuesit.

Tunë Dedaj, uroj kryetarin e sapozgjedhur, Prof. Dr. Zenun Elezajn. “Kam qenë anëtarë i KK për katër vite dhe më lejohet që të marr fjalën dhe të uroj Kryetarin e ri. Për shkak të disa defekteve teknike nuk patëm mundësi ta bëjmë intonimin e himnit kombëtar dhe shtetëror”, shtoi anëtari Dedaj. Në viim anëtari Dedaj për kryesues të Kuvendit të Komunës propozoi anëtarin e KK-së, z. Fadil Gashi.

Esat Raci, theksoi se ne si Grup i anëtarëve të PDK-së nuk kemi kandidat për Kryesues të KK-së.

U propozua dhe u zgjodh Komisioni në këtë përbërje:

Petrit Palushi, propozoi Vlamir Bacajn,
Esat Raci, porpozoi Besart Hotin,
Violeta Zefi, propozor Augustin Selmanin.

Me vota unanime u zgjodh komisioni në këtë përbërje:

- 1. Valmir Bacaj – AAK**
- 2. Besart Hoti – PDK**
- 3. Augustin Selmani - LDK**

U procedua me votimin e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Në vijim Kryesuesi i seancës, z. Morina, sqaroi se janë 26 fletëvotime, 1 mungon, për arsye se në këtë seancë mungon një anëtar, z. Avni Gashi-(AKR).

Esat Raci, sqaroi se GP i PDK-së nuk merr pjesë në votimin për Kryesues të KK-së.

Pas votimit të anëtarëve Komisioni ka konstatuar:

Augustin Selmanaj:” Në kutinë e votimeve prej 26 anëtarëve sa janë prezent, 16 fletëvotime janë vënë në kutinë e votimit, ndërsa 10 nuk janë vënë. 1 fletëvotim mungon për shkak të mosprezencës në seancë të anëtarit Avni Gashi”, sqaroi anëtari Selmanaj.

U konstatua se prej 26 fletëvotimeve 15 kanë votuar për Fadil Gashin.

Kështu që, Fadil Gashi u zgjodh kryesues i AK në Klinë me vota të mjaftueshme.

Kryesuesi i Seancës, Morina konstatoi se me 15 vota për, Fadil Gashi u zgjodh Kryesues i Kuvendit të Komunës së Klinës.

Fadil Gashi, uroj Kryetarin e ri, Zenun Elezajn, i cili në vijim i përshëndeti dhe falënderoi anëtarët e KK dhe të pranishmit.

Fadil Gashi: “ Uroj Kryetarin e Ri, i uroj suksese! Suksesi i tij varet prej ndihmës që i ofrojmë ne Kryetarit të Komunës. Besoj fuqishëm si Kryesues i Kuvendit do ta ketë këtë mbështetje, do të na ketë në përkrahje, dhe përkahja e dyfishtë do të jetë që do të jemi të gjithë pa dallim, prej Kryetarit të Komunës, prej pozitës, prej opozitës, të gjithë kemi qenë në shërbim të qytetarëve njëjtë qysh u kemi garantuar në fushatën fushatën tonë që kemi përfaqësuar politikën tonë, secili duke ruajtur identitetin e vet politik dhe ju garantoj që unë si kryesues, për fat të mirë kanë apsur “lezet’ që të më keni kryesues i Kuvendit, jam hera e dytë që jam dhe kanë provuar punën me mua. Unë besoj që edhe opozita do të ndjehen më mirë me mua se sa kur e kanë paasur, sepse ligji garanton, ligji thotë, Kryesues është njëri prej anëtarëve të Kuvendit. Unë do të jem njëri prej anëtarëve dhe besoj fuqishëm që kemi për të pasur kuvend të mirë, të dinjitetshëm, ku respektohet mendimi, ideja, propozimi, akuza, gjithçka tjetër që zhvillohet në këtë sallë. Dhe, për


fund po i falënderoj mysafirët që ka kanë nderuar për të qenë pjesë e këtij solemniteti tonë, duke përfshirë klerin fetar, policinë, KFOR-in, OSBE-në dhe gjithë jut ë tjerët të pranishëm që jeni këtu , me kërkesën e fundit: ejani në seancat e rregullta në këtë mënyrë qysh jeni këtu e tuje, sepse janë të hapura. Seancat janë edhe tuajat, edhe tonat. Kështu, të jemi të gjithë, edhe kur i zhvillojmë debatet për punën dhe për shërbimin e qytetarëve. Faleminderit shumë!”- është shprehur në fjalën e tij kryesuesi i KK, Fadil Gashi.

Kryesuesi i seancës falënderoi anëtarët për kontributin e dhënë.

Seancën e konstatoi të mbyllur.

Seanca përfundoi në orën 12:15 minuta.

Procesmbajtësi,
Mikel GOJANI



Kryesuesi i Seancës Inauguruese,
Zeqir MORINA

